



WORKSHOP II:

“IDENTIFIKIMI I HAPAVE PËR IMPLEMENTIMIN E KOMPETENCAVE LOKALE NË ÇËSHTJET E MIGRIMIT”

E mërkurë, 30 qershor 2021 | Ora: 10:00 – 11.30 | Vendi: MAK Albania Hotel, Salla Illyria 3

Bashkia e Tiranës në partneritet me Institutin për Bashkëpunim dhe Zhvillim organizon workshopin e 2-të në kuadër të projektit “Përfshirja e migracionit - Rrjeti i Autoriteteve Lokale për Migrim dhe Zhvillim” të titulluar “Identifikimi i hapave për implementimin e kompetencave lokale në çështjet e migrimit”, **më 30 qershor prej orës 10:00, tek MAK Albania Hotel, Salla Illyria 3.**

Ky workshop zhvillohet në kuadër të projektit të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) “Rrjeti i Autoriteteve Lokale për Migracionin dhe Zhvillimin në Mesdhe, Integrimi i Migracionit në Zhvillim”, financuar nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme, me mbështetjen e organizatës italiane CeSPI. Përmes këtij projekti është mundësuar rrjetëzimi mes tre bashkive - Tiranës, Bolonjës dhe Milanos lidhur me integrimin e migrimit në nivelin lokal përmes shkëmbimit të praktikave më të mira dhe pilotimit të veprimeve përkatëse.

Si rezultat i workshopit të parë i cili kishte për qëllim nisjen e dialogut mes institucioneve të përfshira në fushën e migrimit, ky workshop i dytë synon që të diskutoj dhe identifikoj rekomandime konkrete të cilat do ti shërbejnë Bashkisë Tiranë në implementimin e kompetencave të reja legislative në fushën e migrimit.

Pjesëmarrës në këtë workshop do të jenë përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Diasporës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, OJF që merren me fushën e migracionit, etj.



AGJENDA

WORKSHOP II:

“IDENTIFIKIMI I HAPAVE PËR IMPLEMENTIMIN E KOMPETENCAVE LOKALE NË ÇËSHTJET E MIGRIMIT”

E mërkurë, 30 qershor 2021 | Ora: 10:00 – 11.30 | Vendi: MAK Albania Hotel, Salla Illyria 3

- 10:00 – 10:10** **Fjalë hyrëse**
- **Arjeta Rudha**, Bashkia e Tiranës
 - **Krisela Hackaj**, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim
- 10:10 – 10:40** **Prezantim i draft Working Paper** lidhur me rekomandimet për Bashkinë Tiranë
- **Ledjon Shahini**, Ekspert, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim;
 - **Istela Mujollari**, Bashkia Tiranë;
 - **Dafina Peci**, Kongresi Rinor Kombëtar
- 10:40 – 11:10** **Diskutim i hapur** me institucionet aktive në fushën e migrimit
- 11:10 – 11:30** **Identifikimi i rekomandimeve kryesore** për Bashkinë Tiranë dhe vendosja e hapave të radhës për implementimin e tyre
- 11:30** **Pushim kafe**